



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ Nr. / 1413 / 2020

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. 01/ 4805/ 2018 të datës 30.08.2018 dhe Vendimin për ndarjene mjeteve financiar për bursa për student dhe caktimin e prioriteteve për kuadro deficitare në Kuvendin e Komunës Nr.01/261/2019 të datës 31.01.2019, Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport bënë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM (KONKURS)

PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTËT NË KOMUNËN HANI I ELEZIT (2019/2020)

Kushtet për aplikim:

Të drejtë për të aplikuar për bursë kanë të gjithë studentët të cilët plotësojnë këto kushte;

- Të jenë banorë rezidentë të Komunës së Hanit të Elezit,
- Të jenë student-e të rregullt, por jo me vet financim,
- Të kenë regjistruar vitin,
- Studenti-ja nëse një herë ka përsëritur vitin, **humbë të drejtën e bursës (vlenë për gjitha vitet),**
- Të jenë student-e të Universitetit Publik të Kosovës,
- Studenti-ja i cili ka qenë përfutues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfutues i bursës për fakultetin e dytë,
- Studenti-ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejt aplikimi për bursë,

Dokumentet e nevojshme për konkurim:

- Çertifikata e provimeve (**me vulë origjinale**),
- Vërtetimi i semestrit (**me vulë origjinale**),
- Fotokopje ID apo indeksin (fotografën, semestrat dhe notat),
- Deklarata e bashkësisë familjare,
- Çertifikatën e vendbanimit,
- Dëshmia se është; invalid i luftës, fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, familja në skemën sociale, nuk i ka dy prindër, dy dhe një prindër të hendikepuar, i të burgosurit politikë, me gjendje të rënd ekonomike, nuk e ka njërin prind, dëshmi (vërtetim) për punë vullnetare (dy vitet e fundit), për të gjitha këto të cekura më lartë duhet të sjellin dëshminë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse (**me vulë origjinale**),
- Diplomat, mirënjohjet, çertifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin e arsimit(dy vitet e fundit),
- Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë numri i pikëve të testit të arritshmërisë dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës,
- Kopjen e letërnjoftimit dhe
- Vërtetim mbi llogarinë bankare (origjinale)**

Sqarim shtesë: Për bursë kanë **prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë**, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas **Nenit 15 pika 15.1.9.**

Vërejtje: Nëse në dosjen e aplikuesit mungon një dokument apo nuk përputhen të dhënat e kërkuara sipas kriterëve të konkursit, aplikacioni nuk do të shqyrtohet nga ana e komisionit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në **Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të Komunës**. Afati për aplikim është **15 ditë** kalendarike nga dita e publikimit (**fillon-21/02/2020, mbaron 06/03/2020**).

Hani i Elezit
Data: 20.02.2020



Drejtori i DKA-s
Menduh Vlasi